

GJON BORIÇI**VEPRAT E PARA TË MËDHA TË NDËRTUARA
NË SHQIPËRI ME KREDITË KINEZE
(1963 - 1965)****Raporti i Spiro Kolekës* për veprat që i duheshin
Shqipërisë nga Kina**

Gjysma e parë e viteve '60 të shekullit XX, ishte domethënëse në marrëdhëniet shqiptaro-kineze. Pas braktisjes së miqësisë të "pathyeshme" me Bashkimin Sovjetik [më tej: BS], Republikës Popullore të Shqipërisë [më tej: RPSH] i kishte mbetur ku të mbështetej ekonomisht vetëm Republika Popullore e Kinës [më tej: RPK]. Siç e kam nënvizuar edhe në artikujt e tjerë të botuar në revistën "Studime historike", lidhur me marrëdhëniet shqiptaro-kineze, në një periudhë pesëmbëdhjetë vjeçare (1961-1975), RPSH mori nga RPK mbështetje të madhe financiare me anë të kredive me interesa favorizuese. Në këtë artikull, do të ndalem tek një hark kohor dyvjeçar për të sjellë në vëmendjen e studiuesve dhe lexuesit të interesuar për këtë fushë, informacione të reja që kanë të bëjnë me mënyrën sesi Kina i dha Shqipërisë kredi për të ndërtuar vepra të mëdha industriale dhe përse këto vepra ishin të papërballueshme ekonomikisht nga ana e Shqipërisë.

Në një raport të Spiro Kolekës të vitit 1965, që në fakt ishte përmbledhje e vizitës që kishte kryer në Pekin në janar 1961, lidhur me veprat që do të ndërtoheshin në Shqipëri gjatë pesëvjeçarit të tretë 1961-1965¹, ato nuk ishin diçka e re pasi ishin hartuar si projekte në vitin 1958

* *Spiro Koleka* (7 korrik 1908-22 gusht 2001), ministër i Komunikacioneve dhe kryetar i Planit të Shtetit (1948-1958), zëvendëskryeministër (1949-1953), (1956-1966), (1968-1976), anëtar i Byrosë Politike dhe i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

¹ Gjon Boriçi, *Shqipëria dhe Kina - Marrëdhënie e ngushtë në sfondin e Luftës së Ftohtë, Dokumente (1956-1978)*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2020, f. 126; shih edhe Gjon Boriçi, *Marrëdhëniet*

dhe ishin botuar në Fletoren Zyrtare në vitin 1960.² Kreditë që do të merreshin për ndërtimin e këtyre veprave do të vinin nga vendet e demokracive popullore të Evropës. Pas ngjarjeve që morën udhë nga Kongresi XX i PKBS i vitit 1956 dhe atyre të vitit 1960 dhe 1961, sipas Spiro Kolekës, këto vende do t'i shkelnin të gjitha marrëveshjet me Shqipërinë duke e vënë këtë të fundit në një pozitë shumë të vështirë ekonomike.³ Ndihma që RPK-ja i dha Shqipërisë kishte një rëndësi të madhe ekonomike dhe politike dhe sipas Kolekës një "dackë për Hrushovin".⁴

Marrëveshja e nënshkruar më parë në Pekin më 2 shkurt 1961 dhe protokollin e saj i 23 prillit 1961⁵, ishin varka e shpëtimit për Shqipërinë dhe mbi të gjitha për pushtetin e Enver Hoxhës. Me ndihmën e Kinës u ndërtuan një sërë veprash për pesëvjeçarin e tretë ku më të rëndësishmet ishin uzina e azotikut, uzina e superfosfatit, TEC-i i Fierit, uzina e pjesëve të këmbimit për traktorë, fabrikat e çimentos, fabrikat e tullave etj.⁶ Përveç kësaj Kina, i dha me kredi Shqipërisë vepra që nuk parashikoheshin në pesëvjeçar si uzinën e metalurgjisë së zezë, uzinat e përpunimit e rafinimit të bakrit dhe të telave të bakrit, uzinën e sodës dhe fabrikat e letrës, të cilat zëvendësuan vepra të reja të pasiguruara nga vendet e demokracive popullore për pesëvjeçarin e tretë.⁷ Një tjetër pjesë e veçantë e kredisë së akorduar nga Kina kishte të bënte me mekanizimin e punimeve bujqësore, për forcimin e transportit detar dhe hekurudhor dhe mbi të gjitha ndihma e madhe për forcimin e aftësive mbrojtëse të Shqipërisë.⁸ Për ndërtimin e këtyre veprave, ishin caktuar 12 sheshe të

shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë (1956-1978), Tiranë: MIRGEERALB, 2016, f. 115.

² *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 490/ Këshilli i Ministrave (më tej: KM), KM, viti (më tej: V.) 1965, dosja (më tej: D.) 1017, fl. 1. Material i paraqitur palës kineze nga kryetari i delegacionit qeveritar Spiro Koleka për veprat që RPSH ndërton me ndihmën e RP të Kinës dhe ato që ka kërkuar për pesëvjeçarin e katërt 1966-1970.

³ *Po aty*.

⁴ *Po aty*, fl. 2.

⁵ *Po aty*.

⁶ *Po aty*, fl. 3.

⁷ *Po aty*.

⁸ *Po aty*.

mëdha ndërtimi me vendim qeverie që në muajin gusht 1961.⁹ Për ndërtimin e veprave erdhën nga Kina 11 grupe specialistësh me nga 90 veta.¹⁰

Në nëntor të vitit 1962, Byroja Politike e KQ të PPSH dhe Këshilli i Ministrave i RPSH morën në shqyrtim punën e kryer deri në ato momente derisa me vendim të qeverisë më 22 nëntor 1962 u dha pëlqimi i plotë për ndërtimin e veprave industriale me ndihmën e Republikës Popullore të Kinës.¹¹ Ndërtimi i këtyre veprave madhore për Shqipërinë kishte kosto të madhe. Ishte një punë e vërtetë skllëvërishe. Përveç punëtorëve, krahu i punës shtohet edhe me 3 mijë ushtarë të dërguar në ndërtim nga Ministria e Mbrojtjes Popullore, 3 mijë forca të detyruara të dërguara nga Ministria e Punëve të Brendshme, 500 muratorë dhe karpentierë nga komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve.¹²

Qeveria shqiptare me vendim të datës 28 mars 1963, aprovoi ardhjen në Shqipëri të 284 specialistëve kinezë për dhënien e ndihmës teknike në ndërtimin e këtyre veprave.¹³ Gjatë kohës që delegacioni shqiptar kishte qëndruar në Pekin për të negociuar ndërtimin e këtyre veprave, ishin bërë sipas Spiro Kolekës kursime të rëndësishme në vëllimin e ndërtimeve.¹⁴ Kursimet deri në 150 milion lekë për disa vepra¹⁵, bënë që cilësia e tyre të ishte tepër e dobët. Numri i veprave që do të ndërtohej me marrëveshje të ndryshme me Republikën Popullore të Kinës ishte 37 të tilla industriale, kulturore dhe me karakter mbrojtjeje.¹⁶ Sipas Spiro Kolekës,

⁹ *Po aty*, fl. 5.

¹⁰ *Po aty*, fl. 6. Qëndrimi i këtyre grupeve shkonte nga 10 deri në 16 muaj e në raste të rralla nga 4 deri 9 muaj.

¹¹ *Po aty*, fl. 7.

¹² *Po aty*, fl. 7-8.

¹³ *Po aty*, fl. 8.

¹⁴ *Po aty*, fl. 9. Pjesë nga raporti i Spiro Kolekës: "...u bënë kursime të rëndësishme në vëllimin e ndërtimeve, ndër të cilat përmendim për uzinën e superfosfatit rreth 20 milion lekë; për uzinën e metalurgjisë së zezë rreth 17 milion lekë; për uzinën e sodës rreth 13 milionë lekë; për të tri fabrikat e letres afro 8 milion lekë; për të dy fabrikat e çimentos 8 milion lekë; për fabrikat e tullave në Vorë dhe të tullave silikate në Tiranë rreth 6 milion lekë; për kombinatin e tekstileve "Mao Ce Dun" në Berat rreth 9 milion lekë; për TEC-in 4 milion lekë; për uzinën e pjesëve të këmbimit për traktorë mbi 9 milion lekë etj. Vetëm për 15 vepra afro 100 milion lekë kursime në ndërtim".

¹⁵ *Po aty*, fl. 10.

¹⁶ *Po aty*.

vëllimi fillestar i ndërtimeve për mbrojtjen në vitet 1966-1970 do të kapte shumën 400 milion lekë.¹⁷ Pesha specifike e këtyre ndërtimeve do të shkonte deri në 12 miliard e 400 milionë lekë.¹⁸

Për ngritjen e këtyre veprave, Shqipëria vetëm për punëtorë montimi kishte mobilizuar 1424 punonjës.¹⁹ Për vitin 1964 ishin përfunduar me ndihmën dhe kredinë kineze këto vepra: fabrika e shtyllave të centrifuguara, fabrika e thasëve prej letre në Shkodër, fabrika e pllakave prej zdrukthi në Tiranë, uzina metalike në Gjirokastrë dhe vepra nr. 75(?)*. Deri më 30 mars 1965, ishin vënë plotësisht në shfrytëzim pesë vepra.²⁰ Pjesërisht në shfrytëzim ishin vënë fabrika e eternitit në Vlorë dhe vepra nr. 85(?)*.²¹ Veprat që do të përfundonin dhe do të viheshin në shfrytëzim brenda vitit 1965 ishin: uzina e telave prej bakri dhe fabrika e pllakave prej fibre në Shkodër; uzina e përpunimit dhe rafinimit të bakrit në Rubik; fabrika e tullave në Vorë; uzina e pjesëve të këmbimit për traktorë dhe fabrika e tullave silikate në Tiranë; dy fabrikat e letrës në Kavajë dhe në Lushnjë; faza e parë (filatura dhe endja) e kombinatit të tekstileve "Mao Ce Dun"; petëzimi i uzinës së metalurgjisë së zezë në Elbasan dhe veprat nr. 55 e 65(?)*; gjithsej 10 plotësisht dhe 2 pjesërisht.²² Nga 31 vepra gjithsej, brenda pesëvjeçarit të tretë, përfundonin dhe kalonin plotësisht në shfrytëzim 17 vepra dhe 2 të tjera pjesërisht.²³ Plani i vitit 1965 për montimin e këtyre veprave do të ishte 3 miliard e 400 milionë lekë dhe krahasuar me vitin 1964 kishte një rritje prej 44%.²⁴

¹⁷ *Po aty*, fl. 11.

¹⁸ *Po aty*, fl. 12.

¹⁹ *Po aty*, fl. 16. Kjo forcë pune ishte siguruar në këtë mënyrë: 1) 562 punëtorë të përhershëm nga Ministria e Ndërtimit; 2) 179 punëtorë nga investitorët; 3) 223 nga shkollat e rezervave të punës; 4) 460 nga ndërmarrjet e tjera ekonomike

* Në dokumente nuk përmendet cila ishte vepra 75.

²⁰ *Po aty*, fl. 17.

* Në dokumente nuk përmendet cila ishte vepra 85.

²¹ *Po aty*.

* Në dokumente nuk përmendet kush ishin veprat 55 dhe 65.

²² *Po aty*, fl. 17.

²³ *Po aty*.

²⁴ *Po aty*.

Kërkesa nga ana qeverisë shqiptare drejtuar qeverisë kineze dhe angazhimi i Shqipërisë për të qenë zëri i Kinës në arenën ndërkombëtare

Më 27 maj 1963, kryeministri shqiptar Mehmet Shehu i dërgoi një letër homologut të tij kinez Çu En Lai që Kina të ndihmonte Shqipërinë në ndërtimin e uzinës së plehrave azotike.²⁵ Kryeministri Shehu e informoi kolegun e tij kinez se që në vitin 1961, qeveria shqiptare kishte bërë përpjekje për të blerë pajisjet e uzinës në Itali tek firma "Montekatini", por qeveria kineze duke qenë se ishte ajo sponsorizuesja e kësaj uzine, kishte marrë përsipër vetë bisedimet dhe Shqipëria ishte dakord me këtë vendim.²⁶ Për të përfunduar me sukses këtë projekt, nuk ishte dhënë ende asnjë rezultat me gjithë bisedimet e palës kineze me firmat e ndryshme perëndimore për të blerë për Shqipërinë pajisjet e uzinës.²⁷ Kryeministri shqiptar Shehu, i kërkonte homologut të tij kinez që ta shikonte me përparësi këtë çështje, pasi ndërtimi i uzinës ishte me rëndësi të madhe për bujqësinë dhe ekonominë shqiptare.²⁸

Përgjigjja e Çu En Lait ndaj letrës së Mehmet Shehut erdhi më 25 qershor 1963.²⁹ Në letër, Çu En Lai informonte se qeveria kineze për llogari të Shqipërisë kishte bërë bisedime me firma të ndryshme perëndimore italiane, angleze dhe austriake. Vonesa për ndërtimin e uzinës në Shqipëri kishte ndodhur pasi firma britanike "British Shell" kishte refuzuar të shiste patentën dhe pjesët teknike për prodhimin e gazit.³⁰ Lidhur me këtë çështje, drejtori i Drejtorisë Qendrore për Lidhjet Ekonomike me Jashtë i Kinës, Fan I, kishte njoftuar hollësisht ambasadorin shqiptar në Pekin, Reiz Malilen.³¹ Në fund të letrës,

²⁵ AQSH, F. 490/ KM, V. 1963, D. 1084, fl. 1. Letërkëmbim ndërmjet qeverisë së RP të Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Popullore të Kinës për blerjen nga ana e Republikës Popullore të Shqipërisë në Kinë të uzinës për prodhimin e plehrave azotikë.

²⁶ *Po aty*.

²⁷ *Po aty*, fl. 2.

²⁸ *Po aty*, fl. 3.

²⁹ *Po aty*, fl. 10.

³⁰ *Po aty*, fl. 12.

³¹ *Po aty*.

kryeministri kinez premtonte se nga ana e vendit të tij do të bëheshin të gjitha përpjekjet që kjo uzinë të ndërtohej në Shqipëri.³²

Nëse Shqipëria kërkonte kredi nga Kina për të ndërtuar vepra industriale, atëherë patjetër që e kishte të domosdoshme të mbronte çdo pikëpamje kineze në arenën ndërkombëtare. Më 2 gusht 1963, kryeministri kinez Çu En Lai i dërgoi një letër informuese kryeministrit shqiptar Mehmet Shehu në lidhje me propozimet kineze për çarmatimin bërthamor.³³ Në këtë letër, kryeministri kinez informoi homologun e tij në Tiranë se më 31 korrik 1963, qeveria kineze kishte bërë një deklaratë prej disa pikash drejtuar kryetarëve të qeverive të botës si të atyre vendeve që posedonin armë bërthamore dhe atyre që nuk kishin për ndalimin dhe shkatërrimin e plotë, përfundimtar dhe kategorik të armëve bërthamore.³⁴ Deklarata kineze synonte që çdo vend i cili kishte apo synonte të prodhonte armë bërthamore ta ndërpriste menjëherë këtë aktivitet dhe të ndaloheshin të gjitha provat bërthamore edhe ato të nëndheshme.³⁵ Për t'ia arritur këtij qëllimi kërkohet thirrja e një konference të kryetarëve të qeverive të të gjitha vendeve për të diskutuar problemin e ndalimit të plotë dhe shkatërrimit përfundimtar të armëve bërthamore dhe marrjen e masave për realizimin gradual të këtij projekti.³⁶

Përpara se t'i kthente përgjigje kryeministrit kinez, më 5 gusht 1963, Mehmet Shehu pati një takim informues me ambasadorin e RPK-së në Tiranë, Lo Shi Gao.³⁷ Traktatin e Moskës të 25 korrikut 1963, kryeministri Shehu e cilësoi bashkëkomplot të Nikita Hrushovit dhe të imperializmit amerikan edhe kundër vetë interesave të larta të Bashkimit Sovjetik, të Kampit Socialist dhe të Lëvizjes Komuniste

³² *Po aty*, fl. 13.

³³ *Po aty*, F. 490/KM, V. 1963, D. 1083, fl. 6. Deklaratë e qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, letër e qeverisë së RP të Kinës dhe stenogramet e bisedave të Kryetarit të Këshillit të ministrave të RP të Shqipërisë me ambasadorin kinez në Tiranë, mbi traktatin sovjetico-amerikan për ndalimin e provave të armës bërthamore, si dhe për propozimet kineze për këtë çështje.

³⁴ *Po aty*, fl. 7.

³⁵ *Po aty*, fl. 8.

³⁶ *Po aty*.

³⁷ *Po aty*, fl. 13. Bisedë e kryetarit të Këshillit të Ministrave, Mehmet Shehu, me ambasadorin e Republikës Popullore të Kinës, Lo Shi Gao.

Ndërkombëtare.³⁸ Gjithashtu, për kryeministrin shqiptar ky traktat sovjeto-amerikan drejtohej kryesisht kundër Republikës Popullore të Kinës.³⁹ Për udhëheqjen shqiptare, Bashkimi Sovjetik me Nikita Hrushovin në krye kishte ngritur lart flamurin e tradhtisë kundër interesave të larta të Kampit Socialist.⁴⁰ Republika Popullore e Kinës sipas Mehmet Shehut, ishte forca e vetme që i kishte dalë përballë rrugës së tradhtisë së Hrushovit.⁴¹ Sipas Shehut, së shpejti edhe qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë do të lëshonte një deklaratë mbi traktatin për ndalimin e pjesshëm të provave bërthamore duke e denoncuar atë si komplot kundër Kampit Socialist dhe veçanërisht kundër Republikës Popullore të Kinës.⁴² Për qeverinë shqiptare, Traktati i Moskës ishte i paligjshëm, sepse ishte bërë pa u konsultuar me vendet e Traktatit të Varshavës, pjesë e të cilit vijonte të ishte ende Shqipëria.⁴³ Por, përpara se Shqipëria të dilte hapur dëshironte të konsultohej me Republikën Popullore të Kinës lidhur me këtë çështje. Mehmet Shehu i tha ambasadorit Gao se qeveria shqiptare e kishte gati deklaratën, por kërkonte më parë që qeveria e RPK-së të jepte mendimin e saj, mundësisht brenda dy-tri ditëve.⁴⁴

Propozimin e qeverisë sovjetike për përfundimin e një pakti mossulmimi me vendet e NATO-s, qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, sipas Shehut, e kishte mbështetur.⁴⁵ Por, në kushtet aktuale, kur qeveria sovjetike kishte kapitulluar, sipas tij, me krizën kubane të raketave në vitin 1962, ky pakt kishte kuptimin e aleancës së hapur imperialisto-revizioniste kundër Republikës Popullore të Kinës.⁴⁶ Me të qenurit të sigurtë në Evropë, për mospasjen luftë me Bashkimin Sovjetik, vendet kryesore të NATO-s, do të kishin dorë të lirë të sulmonin Kinën, sipas Mehmet Shehut.⁴⁷ Lidhur me këtë çështje, kryeministri shqiptar

³⁸ *Po aty.*

³⁹ *Po aty.*

⁴⁰ *Po aty*, fl. 14.

⁴¹ *Po aty.*

⁴² *Po aty*, fl. 16.

⁴³ *Po aty.*

⁴⁴ *Po aty*, fl. 17.

⁴⁵ *Po aty.*

⁴⁶ *Po aty.*

⁴⁷ *Po aty.*

informoi ambasadorin kinez se Shqipëria ishte e gatshme ta shtronte edhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork.⁴⁸ Zëri i Kinës në OKB, fliste me zërin e Shqipërisë duke qenë se në atë organizatë, Kina përfaqësohej nga Tajvani. Çështja e pranimit të saj [Kinës] në OKB ishte shtruar për t'u përfshirë në rendin e ditës nga shtete të ndryshëm si Bashkimi Sovjetik dhe India, por Shqipëria kërkonte që zyrtarisht në emër të Kinës të bënte kërkesë për anëtarësimin e shtetit të madh aziatik në OKB.⁴⁹ Ambasadori kinez u tregua i kujdesshëm ndaj kësaj kërkesë të Mehmet Shehut dhe nuk i dha asnjë përgjigje. Patjetër që më parë do të duhej të konsultohesh me qeverinë e vendit të tij.

Sipas ambasadorit Gao, kjo frazë përputhej me propagandën e përgjithshme të Shqipërisë për të fituar simpatinë e shtresave të gjera që ndodheshin në pozita të ndërmjetme dhe se do të kishte një efekt shumë të mirë politik.⁵⁰ Ishte i qartë fakti se tezat kryesore të politikës ndërkombëtare me të cilat paraqitej Shqipëria në OKB ishin përgatitur në Pekin.

Përsa i përkiste shtrimit të çështjes së Kinës në OKB, ambasadori Gao u shpreh se qeveria e vendit të tij e mbështeste nxehtësisht iniciativën e Republikës Popullore të Shqipërisë me një zë të fortë në kontrast me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe dhe Bashkimit Sovjetik si dhe të demaskonte fuqishëm klikën e Çan Kai Shisë në OKB.⁵¹ Qeveria e Republikës Popullore të Kinës ishte dakord që pala shqiptare të paraqiste për vënie në diskutim në rendin e ditës në OKB çështjen e rivendosjes së të drejtave të Kinës në organizatë dhe të ngrinte zërin për përjashtimin e përfaqësuesve të Çan Kai Shisë.⁵²

Ministri i Punëve të Jashtme i Shqipërisë, Behar Shtylla, i pranishëm në këtë takim, kërkoi të dinte pak më shumë lidhur me "lejen" që Kina i jepte Shqipërisë lidhur me rivendosjen e të drejtave të saj në OKB. Ambasadori Gao u shpreh se qeveria e RPK-së mbështeste çdo iniciativë të Shqipërisë në kohën që ajo e quante të përshtatshme.⁵³ Në takim u ra dakord që Shqipëria të kërkonte për t'u vendosur në rendin e ditës më

⁴⁸ *Po aty*, fl. 19.

⁴⁹ *Po aty*.

⁵⁰ *Po aty*.

⁵¹ *Po aty*.

⁵² *Po aty*, fl. 26.

⁵³ *Po aty*, fl. 27.

datë 17 shtator 1963 kjo çështje, kur do të fillonte punimet Asambleja e Përgjithshme e OKB-së.⁵⁴

Pas takimit me ambasadorin kinez, Republika Popullore e Shqipërisë bëri publike deklaratën kundër Traktatit sovjeto-amerikan sipas së cilës ishte përgatitur nga Pekini zyrtar për ndalimin e pjesëshëm të armëve bërthamore më 15 gusht 1963, me besnikëri të gjithë mendimet e shprehura nga takimi Shehu-Gao.⁵⁵

Megjithatë, në politikë është i qartë fakti se ndryshe flet dhe ndryshe vepron. Po kështu edhe në këtë rast. Një vit më pas, më datë 17 tetor 1964, kryeministri kinez Çu En Lai njoftoi homologun e tij shqiptar Mehmet Shehu, se më datë 16 tetor 1964, Republika Popullore e Kinës kishte testuar me sukses provën e parë bërthamore.⁵⁶ Edhe pse Kina, sipas kryeministrit kinez, ishte për ndalimin e armëve bërthamore, në kushtet kur të dyja superfuqitë nuk kishin hequr dorë nga ato, Kina ishte e detyruar të kishte armë bërthamore vetëm për qëllime mbrojtëse.⁵⁷ Qeveria kineze premtojte solemnisht se nuk do të ishte asnjëherë e para që do të përdorte armën bërthamore.⁵⁸ Qeveria kineze do të vijonte pareshtur përpjekjet për të realizuar ndalimin e përgjithshëm dhe shkatërrimin e plotë të armëve bërthamore me anën e konsultimeve ndërkombëtare.⁵⁹

Nga ana e tij, kryeministri Mehmet Shehu iu përgjigj letrës së Çu En Lait më 3 nëntor 1964.⁶⁰ Eksperimentin e bombës bërthamore nga ana e Republikës Popullore të Kinës, Mehmet Shehu e quajti një sukses të madh dhe arritje të shkëlqyer të popullit kinez për forcimin e aftësive

⁵⁴ *Po aty*.

⁵⁵ *Po aty*, fl. 37.

⁵⁶ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1964, D. 1259, f. 3.

⁵⁷ *Po aty*.

⁵⁸ *Po aty*.

⁵⁹ *Po aty*. Pjesë nga letra e Çu En Lait dërguar Mehmet Shehut: "Të thirret mbledhja e kryetarëve të shteteve të botës për të diskutuar çështjen e ndalimit të plotë dhe të zhdukjes së plotë të armëve bërthamore. Si hap i parë për këtë, në mbledhjen e kryetarëve të shteteve duhet të arrihet marrëveshja që vendet që i zotërojnë armët bërthamore, si dhe vendet që mund t'i zotërojnë ato së shpejti të zotohen të mos i përdorin armët bërthamore, të mos i përdorin ato kundrejt vendeve jo bërthamore, të mos i përdorin ato kundrejt zonave të çatomizuara, të mos i përdorin ato gjithashtu midis tyre".

⁶⁰ *Po aty*, fl. 5.

mbrojtëse të tij.⁶¹ Edhe gjatë këmbimeve të mesazheve të 31 korrikut dhe 19 gushtit 1963, qeveria e RPSH-së gjithnjë ishte shprehur në vijimësi të politikës kineze për ndalimin e armëve bërthamore dhe e konsideronte këtë lëvizje të re të Kinës për mospërdorimin e para të armëve bërthamore si një iniciativë konstruktive.⁶²

Duke qenë se marrëdhëniet shqiptaro-kineze po ecnin në rrugën e forcimit të vazhdueshëm, më datë 27 nëntor 1963, kryeministri shqiptar Mehmet Shehu, me anë të një letre shumë të përzemërt i bënte ftesë zyrtare kryeministrit kinez Çu En Lai për të vizituar në kohën që ai do ta gjykonte të përshtatshme Shqipërinë.⁶³ Në fakt, nuk ishte hera e parë që Mehmet Shehu i kishte bërë ftesë Çu En Lait. Që në vizitën e parë në Kinë në vitin 1956, kryeministri shqiptar e kishte ftuar homologun e tij kinez që të vizitonte Shqipërinë.⁶⁴ Në fund të letrës kryeministri Shehu përveç mirënjohjes për ndihmat nga ana e Kinës, shprehte bindjen se vizita e kryeministrit kinez në Shqipëri do të forconte akoma më shumë marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve.⁶⁵ Kryeministri kinez Çu En Lai, pas

⁶¹ *Po aty*. Pjesë nga letra e Mehmet Shehut dërguar Çu En Lait: "Populli shqiptar, Partia e Punës e Shqipërisë dhe qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, sikundër e vinim në dukje edhe në mesazhin tonë të datës 17 tetor 1964, e përshëndetëm me gjithë zemër këtë sukses të shkëlqyer të popullit vëlla kinez dhe e konsiderojmë atë si një fitore të madhe në forcimin e aftësive mbrojtëse të Republikës Popullore të Kinës e të mbarë kampit socialist, dhe si një kontribut të madh në luftën për sigurimin e paqes në botë dhe kundër politikës së shantazhit bërthamor dhe të agresionit imperialist të Shteteve të Bashkuara të Amerikës".

⁶² *Po aty*, fl. 6. "Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, e cila do të luftojë kurdoherë pa u lodhur së bashku me Republikën Popullore të Kinës dhe vendet e tjera paqedashëse për sigurimin e paqes, kundër politikës agresive të imperializmit, sidomos të imperializmit amerikan, shpreh besimin se ky propozim i rëndësishëm i qeverisë së Republikës Popullore të Kinës do të gjejë përkrahjen e të gjitha shteteve dhe popujve paqedashës që janë sinqerisht për ndalimin e armëve bërthamore, për çarmatimin dhe për paqen".

⁶³ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1963, D. 1085, fl. 1. Ftesë e qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë drejtuar Kryetarit të Këshillit të Shtetit të Republikës Popullore të Kinës për të vizituar Shqipërinë.

⁶⁴ *Po aty*.

⁶⁵ *Po aty*, fl. 2. Pjesë nga letra e Mehmet Shehut dërguar Çu En Lait: "Populli shqiptar dhe qeveria e tij janë dhe do të jenë kurdoherë mirënjohëse ndaj popullit vëlla kinez, Qeverisë dhe partisë së tij Komuniste të lavdishme për gjithçka që kanë bërë dhe bëjnë në drejtim të Republikës Popullore të Shqipërisë, veçanërisht në situatat e vështira që ka kaluar vendi ynë, për ndihmën e madhe dhe pa interes që Republika Popullore e

kësaj ftese erdhi në Shqipëri më 31 dhjetor 1963, dhe qëndroi deri më 9 janar 1964.⁶⁶

Ndërtimi i kombinatit të tekstileve Berat në vitin 1964

Ndihmesa që jepte Shqipëria në OKB për të drejtat e Kinës, shoqërohej nga ana tjetër me kërkesa të shumta për ndërtimin industrial të vendit. Më datë 18 maj 1964, kryeministri i Republikës Popullore të Shqipërisë, Mehmet Shehu, pati një bisedë me ambasadorin e Republikës Popullore të Kinës në Tiranë, Lo Shi Gao.⁶⁷ Kombinati i tekstileve në qytetin e Beratit që do të ndërtohej me ndihmat kineze, do të quhej Mao Ce Dun.⁶⁸ Sipas bisedimeve që ishin kryer në Pekin më datë 28 prill 1964 ndërmjet Çu En Lait dhe Irakli Vakëfliut*, ishte rënë dakord që të ndërtohej ky kombinat.⁶⁹ Sipas Mehmet Shehut, ky kombinati ishte një tjetër ndihmë e madhe që Kina jepte për ekonominë shqiptare.⁷⁰ Kombinati filloi të ndërtohej menjëherë pas përfundimit të vizitës 10 ditore të Çu En Lait në Shqipëri.⁷¹ Kombinati i tekstileve "Mao Ce Dun" do të ndërtohej pa importuar pajisje nga vendet perëndimore.⁷² Çdo pajisje për këtë kombinat do të vinte nga Republika Popullore e Kinës. Pajisjet që do të nevojiteshin për funksionimin e tij do të kishin një efikasitet prej 10-15 vjetësh.⁷³

Në bisedë e sipër Mehmet Shehu i premtoi ambasadorit kinez se, në asnjë mënyrë, ndërtimi i këtij kombinati nuk do të prekte sipërfaqet e

Kinës i ka dhënë dhe i jep Republikës Popullore të Shqipërisë në ndërtimin socialist të vendit".

⁶⁶ Për vizitën e kryeministrit kinez në Shqipëri dhe për bisedimet ekonomike që janë zhvilluar ndërmjet palës shqiptare dhe asaj kineze kam folur gjerësisht në librin tim *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë (1956-1978)*..., f. 121-132.

⁶⁷ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1964, D. 1258, fl. 1. Bisedë ndërmjet kryetarit të Këshilli të Ministrave të RP të Shqipërisë me ambasadorin e RP të Kinës në Tiranë për problemet e ndërtimit të Kombinatis të Tekstileve në Berat.

⁶⁸ *Po aty*.

* *Irakli Vakëfliu*, inxhinier shqiptar.

⁶⁹ *Po aty*.

⁷⁰ *Po aty*.

⁷¹ *Po aty*, fl. 2; shih edhe Gj. Boriçi, *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë*..., f. 125.

⁷² *Po aty*.

⁷³ *Po aty*, fl. 3.

drithërave të bukës as në vitet 1970 dhe 1975, kur pritej zgjerimi i tij.⁷⁴ Shqipëria deri në këtë moment sipas kryeministrit Shehu, mbillte 24 mijë ha tokë me pambuk dhe kishte arritur një rendiment mesatar vjetor prej 10.5 kv/ha.⁷⁵ Shqipëria duke e rritur rendimentin e pambukut në 14 kv/ha në vitin 1970, plotësonte tërësisht nevojat e vendit për pambuk pa shtuar aspak sipërfaqen e tokës së mbjellë me këtë bimë.⁷⁶

Ndërkaq nga ana e tij, ambasadori Gao e njoftoi kryeministrin Shehu mbi përfundimin e veprave të tjera me kreditë kineze. Gjatë vizitave të tij në Shkodër kishte parë përfundimin e ndërtimit të fabrikës së telave të bakrit dhe të letrës për thasë çimentoje.⁷⁷ Gjithashtu, në Elbasan kishte përfunduar objekti nr. 75 i uzinës metalurgjike.⁷⁸ Por, veprat që të ndërtoheshin në Shqipëri me ndihmën e Kinës kërkonin krahë të shumtë pune. Këtë fakt e vërteton Mehmet Shehu kur pranon se vetëm për TEC-in e Fierit, përveç mjeshtërve dhe specialistëve të ndryshëm ishin thirrur të punonin edhe 1700 ushtarë dhe rreth 1000 punëtorë civilë.⁷⁹ Zëvendëskryeministri Spiro Koleka kërkonte 25 inxhinierë ndërtimi, qeveria shqiptare kishte vetëm 20.⁸⁰ Sipas Spiro Kolekës, i pranishëm në këtë takim, Shqipëria kishte nevojë të ngutshme nga Kina për të siguruar materiale ndërtimi veçanërisht hekur "tahl-5" me diametër 22 deri 32m/m.⁸¹

Kina "pata" që bënte vezë të arta për Shqipërinë

Shqipëria nuk reshtte së kërkuari kredi nga Kina. Për vitin 1965, Mehmet Shehu i dërgoi më 22 janar 1965, Çu En Lait një tjetër letër ku i kërkonte një kredi të re për pesëvjeçarin e katërt, 1966-1970.⁸² Pasi e

⁷⁴ *Po aty*, fl. 4.

⁷⁵ *Po aty*.

⁷⁶ *Po aty*.

⁷⁷ *Po aty*, fl. 5.

⁷⁸ *Po aty*.

⁷⁹ *Po aty*, fl. 6.

⁸⁰ *Po aty*.

⁸¹ *Po aty*.

⁸² *AQSH*, F. 490/KM, V. 1965, D. 1011, fl. 1. Letërkëmbim ndërmjet qeverisë së RP të Shqipërisë dhe qeverisë së RP të Kinës për dhënie kredie RP të Shqipërisë për pesëvjeçarin e katërt (1966-1970).

falënderonte kryeministrin kinez për interesimin e posaçëm për të plotësuar nevojat ekonomike të Shqipërisë, Mehmet Shehu jepte sqarime të detajuara se çfarë i duhej vendit të tij për pesëvjeçarin e katërt 1966-1970. Sipas Shehut, pesëvjeçari i tretë ishte një përpjekje serioze për kapërcimin e vështirësive të krijuara nga bllokada ekonomike e vendeve revizioniste ndaj Shqipërisë.⁸³ Për faj të tyre, sipas Shehut, ndërtimi i objekteve kryesore industriale për pesëvjeçarin e tretë kishte filluar me vonesë, në gjysmën e dytë të vitit të tretë të pesëvjeçarit.⁸⁴ Tashmë të gjitha këto objekte po ndërtoheshin me ndihmën e Republikës Popullore të Kinës. Uzinat e ndryshme si ajo e plehut azotik në Fier, dy fabrikat e çimentos në Tiranë, uzina e superfosfatit në Laç, fabrikat e tullave dhe uzina e pjesëve të këmbimit për traktorë në Tiranë, të gjithë këto objekte të domosdoshëm për ekonominë shqiptare, do të ndërtoheshin me vonesë.⁸⁵ Megjithatë, sipas Shehut, Shqipëria edhe pse me vështirësi ishte në rrugë të mbarë për kthimin e vendit nga agraro-industrial në industrialo-agrar sipas vendimeve të Kongresit IV të PPSH-së.⁸⁶

Volumi i përgjithshëm industrial, sipas Shehut, për pesëvjeçarin e tretë do të arrinte në 96%, prodhimi bujqësor në 83%; volumi i përgjithshëm i investimeve 93%; volumi i përgjithshëm i ndërtimeve 104%; volumi i përgjithshëm i qarkullimit të mallrave të konsumit të gjerë, 93%.⁸⁷ Në këtë mënyrë, sipas Shehut, në vitin 1965 krahasuar me vitin 1960, prodhimi industrial do të ishte 36% më i madh, prodhimi bujqësor 48% më i madh, volumi i qarkullimit të mallrave të konsumit të gjerë 26% më i madh.⁸⁸ Investimet për të pesë vitet e pesëvjeçarit të tretë të marra së bashku, do të realizoheshin sipas kryeministrit shqiptar afërsisht në masën 40% më shumë se volumi i përgjithshëm i investimeve në të pesë vitet e pesëvjeçarit të dytë dhe ndërtimet 67% më shumë.⁸⁹

⁸³ *Po aty*, fl. 2.

⁸⁴ *Po aty*.

⁸⁵ *Po aty*, fl. 3.

⁸⁶ *Po aty*.

⁸⁷ *Po aty*, fl. 4.

⁸⁸ *Po aty*.

⁸⁹ *Po aty*.

Bllokada hrushoviane siç e cilësonte Shehu, kishte krijuar vështirësi për sigurimin e rezervës shtetërore minimale.⁹⁰ Për këtë arsye, paga reale e punonjësve shqiptarë në fund të vitit 1965 do të ishte më e madhe se ajo e vitit 1960 vetëm në masën 2.2% dhe jo 30% siç parashikohej.⁹¹ Të ardhurat e fshatarësisë në fund të pesëvjeçarit të tretë parashikoheshin të ishin vetëm 17% dhe jo 35%.⁹² Projekt-plani parashikonte që në fund të pesëvjeçarit të katërt, prodhimi industrial do të rritej me 42%, kundrejt rritjes prej 36% në pesëvjeçarin e tretë.⁹³ Sipas Shehut, rritja industriale e Shqipërisë kishte qenë e ulët nga pesëvjeçari i parë në të tretin. Sipas shifrave që na paraqet ky dokument i nënshkruar prej kryeministrit Shehu, në pesëvjeçarin e parë rritja mesatare vjetore e prodhimit të përgjithshëm industrial ishte 22.6%, në pesëvjeçarin e dytë kishte rënë në 16.9%, dhe në pesëvjeçarin e tretë në 6.4%.⁹⁴ Po të ishte i suksesshëm plani i katërt pesëvjeçar, kjo rënie do të stoponte dhe do të kapte shifrën e rritjes 7.3%.

Në projektplanin e pesëvjeçarit të katërt, parashikohej që të ndërtoheshin me ndihmën e Republikës Popullore të Kinës, 13 objekte të plota industriale, 12 reparte të ndryshëm industrialë pranë uzinave dhe fabrikave ekzistuese.⁹⁵ Ndër këto objekte, tre ishin ato më të rëndësishmit: hidrocentrali i Vaut të Dejës mbi lumin Drin, uzina metalurgjike për shkrirjen e mineralit të hekur-nikelit dhe petëzimin e metalit dhe uzina për prodhimin e ferrokromit të rafinuar.⁹⁶ Një tjetër objekt i rëndësishëm që pritej të ndërtohej me ndihmën e RPK-së ishte edhe termocentrali elektrik i Fierit me fuqi 74 mijë kw, në bazë të marrëveshjes së përfunduar me Kinën për pesëvjeçarin e tretë.⁹⁷

Sipas studimeve të kryera, burimet hidroenergjetike të Shqipërisë zinin 68% të të gjitha rezervave të burimeve energjetike, ndërsa lëndët djegëse 32%.⁹⁸ Në lumin Drin mund të ndërtoheshin hidrocentrale me

⁹⁰ *Po aty.*

⁹¹ *Po aty.*

⁹² *Po aty*, fl. 5.

⁹³ *Po aty*, fl. 5-6.

⁹⁴ *Po aty*, fl. 6.

⁹⁵ *Po aty*, fl. 7.

⁹⁶ *Po aty.*

⁹⁷ *Po aty*, fl. 7-8.

⁹⁸ *Po aty*, fl.8.

fuqi të përgjithshme 1.2 milion kw.⁹⁹ Këto hidrocentrale nëse ndërtoheshin, do të prodhonin çdo vit rreth 6 miliard kw/h energji elektrike. Sasia e përgjithshme e energjisë elektrike që mund të jepnin hidrocentralet në të gjithë lumenjtë e Shqipërisë do të ishte rreth 8 miliard kw/h.¹⁰⁰

Sipas skemës që kishte paraqitur qeveria shqiptare, hidrocentrali që do të ndërtohej në lumin Drin do të ishte ai i Fierzës me fuqi 360 mijë kw.¹⁰¹ Por, ky hidrocentral kërkonte një kohë relativisht të gjatë për t'u ndërtuar dhe, për plotësimin e nevojave të vendit me energji elektrike, do të fillonte të ndërtohej në vitin 1967, dhe të përfundonte në vitin 1972 hidrocentrali i Vaut të Dejës.¹⁰² Hidrocentrali i Fierzës të përgatitej të fillonte për ndërtim në fund të pesëvjeçarit të katërt 1966-1970 dhe të vihej në shfrytëzim në pesëvjeçarin e gjashtë 1976-1980.¹⁰³

Një nga pasuritë më të mëdha të nëntokës shqiptare ishte ajo e hekur-nikelit me rreth 150 milion ton nga të cilët rezervat industriale përbënin 80 milion ton.¹⁰⁴ Sipas këtyre përllogaritjeve, kryeministri Shehu mendonte se ekzistonte në Shqipëri një bazë e shëndoshë e lëndës së parë për ngritjen e metalurgjisë së përpunimit të gjithanshëm të mineral-nikelit për të marrë prodhime hekuri si dhe për të vlerësuar komponentët e tjerë si nikelin dhe kobaltin.¹⁰⁵ Me marrëveshjen e kredisë për pesëvjeçarin e tretë, parashikohej ndërtimi i uzinës metalurgjike me aftësi prodhimi 30 mijë ton çelik në vit e barabartë me shkrirjen e rreth 100 mijë ton mineral-nikeli.¹⁰⁶ Sipas përllogaritjeve shqiptare, kjo uzinë do të hynte në punë në dy etapa: etapa e parë do të përfshinte vënien në shfrytëzim të pjesës së kapacitetit të shkrirjes së 100 mijë ton mineral në vitin 1970 dhe etapa e dytë, me kapacitet të plotë prej 300 mijë ton mineral për shkrirjen dhe përpunimin e metalit përkatës për vitet 1972-1973.¹⁰⁷

⁹⁹ *Po aty*.

¹⁰⁰ *Po aty*.

¹⁰¹ *Po aty*.

¹⁰² *Po aty*, fl. 9.

¹⁰³ *Po aty*.

¹⁰⁴ *Po aty*.

¹⁰⁵ *Po aty*.

¹⁰⁶ *Po aty*, fl. 10.

¹⁰⁷ *Po aty*, fl. 11.

Një tjetër industri që kërkonte të ndërtonte Shqipëria ishte edhe ajo e kromit. Sipas studimeve që paraqiti Mehmet Shehu në letrën dërguar Çu En Lait, vendi kishte rreth 4.3 milion ton mineral kromi.¹⁰⁸ Shqipëria deri në këtë moment eksportonte të gjithë mineralin e kromit që prodhonte, 300 mijë ton në vit.¹⁰⁹ Nga minerali i kromit të Bulqizës, dërgoheshin çdo vit në Kinë rreth 65 mijë ton.¹¹⁰ Shqipëria kishte parashikuar që të fillonte të ndërtonte uzinën metalurgjike për prodhimin e ferrokromit të rafinuar me kapacitet prodhimi rreth 20 mijë ton në vit, e barabartë me përpunimin e rreth 65 mijë ton mineral kromi në vit dhe të përfundonte në vitin 1972.¹¹¹ Sipas Mehmet Shehut, ndërtimi i një uzine të tillë kishte leverdi pasi do të rriste të ardhurat e vendit në valutë.¹¹²

Një tjetër industri që kishte nevojë të ndërtonte Shqipëria ishte ajo e naftës. Projektplan i pesëvjeçarit të katërt parashikonte që prodhimi i naftës në vitin 1970 të arrinte në 1 milion ton, kundrejt 820 mijë ton që ishte plani i vitit 1965.¹¹³ Nëse për pesëvjeçarin e katërt nuk do të arrihej të kryhej volumi i investimeve të kërkuara, rritja e mëtejshme e prodhimit industrial do të kompromentohej, do të vinte duke u ulur, sipas Shehut, dhe do të krijoheshin vështirësi shumë të mëdha në bilancin e tregtisë së jashtme.¹¹⁴ Një tjetër objektiv që kishte qeveria shqiptare, ishte edhe sigurimi i bukës brenda vendit.¹¹⁵ Por edhe nëse do të arrihej prodhimi prej 465 mijë ton drithëra në vitin 1970, përsëri nuk mjaftonte për sigurimin e bukës në vend.¹¹⁶ Për këtë arsye, Shqipërisë i duhej të importonte edhe 650 mijë ton drithëra buke për pesëvjeçarin e katërt.¹¹⁷ Në fund të pesëvjeçarit të katërt, qeveria shqiptare kishte parashikuar që zonat fshatare sidomos ato kodrinore dhe malore ta siguronin vetë farën e bukës.¹¹⁸

¹⁰⁸ *Po aty.*

¹⁰⁹ *Po aty.*

¹¹⁰ *Po aty.*

¹¹¹ *Po aty.*

¹¹² *Po aty.*

¹¹³ *Po aty*, fl. 13.

¹¹⁴ *Po aty*, fl. 15.

¹¹⁵ *Po aty.*

¹¹⁶ *Po aty*, fl. 16.

¹¹⁷ *Po aty.*

¹¹⁸ *Po aty*, fl. 17.

Mehmet Shehu njoftoi kryeministrin kinez se për t'ia arritur kësaj, qeveria shqiptare kishte vendosur një regjim rigoroz dhe të përpiktë për të mos lejuar lëvizjen spontane të fuqisë punëtore nga fshati në qytet duke u nisur nga kriteri se vetëm kur të ishte përdorur e gjithë fuqia punëtore e qyteteve për ndërmarrjet shtetërore, vetëm atëherë në bazë të një plani të mund të tërhiqej fuqi punëtore nga fshati.¹¹⁹ Ky element tregon fare qartë sesa ende larg mbetej Shqipëria nga procesi i urbanizimit.

Prodhimi i frutikulturës do të kishte, sipas Shehut, një rritje prej 52%.¹²⁰ Por, duke parë rëndësinë e madhe që po i jepej industrisë së rëndë, për bujqësinë dhe frutikulturën mbetej shumë pak nga kredia që po i kërkohej Kinës. Kjo vërtetohet nga bilanci që bën vetë Mehmet Shehu në fund të letrës kur pranon se 80% e investimeve me kredinë kineze do të jepeshin për sektorët prodhues dhe 20% në sektorët jo prodhues. Nga këto 23% do t'i jepeshin sektorit të minierave, afro 18% sektorit të industrisë, rreth 22% sektorit të bujqësisë, rreth 10% sektorit të komunikacionit.¹²¹ Pra, sektori i industrisë së rëndë do të merrte 41% të investimeve, kur vetë Mehmet Shehu pranonte se Shqipëria nuk siguronte dot bukën në vend. Shqipëria kërkonte një kredi prej 58 milion e 950 mijë rubla nga Republika Popullore e Kinës, e përdorshme brenda periudhës 1966-1970 dhe të shlyhej nga Republika Popullore e Shqipërisë pas vitit 1990.¹²²

Përgjigja nga Çu En Lai mbërriti më 18 shkurt 1965.¹²³ Kryeministri kinez kërkoi në letër që përpara se të aprovohej kredia nga pala kineze, Shqipëria të dërgonte një grup specialistësh për të bërë propozimet konkrete lidhur me këtë çështje.¹²⁴ Bisedimet ndërmjet të dërguarve të qeverisë shqiptare dhe qeverisë kineze u zhvilluan me muaj të tërë. Më në fund, Kina pranoi t'i jepte Shqipërisë një kredi të re për planin ekonomik të pesëvjeçarit të katërt 1966-1970 në shumën prej 170 milion rublash.¹²⁵

¹¹⁹ *Po aty*.

¹²⁰ *Po aty*, fl. 18.

¹²¹ *Po aty*, fl. 21.

¹²² *Po aty*, fl. 25, fl. 31, fl. 32, fl. 34, fl. 35, fl. 37, fl. 40.

¹²³ *Po aty*, fl. 47.

¹²⁴ *Po aty*, fl. 46.

¹²⁵ *Po aty*, fl. 50; shih Frank Dikötter, *Mao's great famine; the history of China's most devastating catastrophe, 1958-1962*, New York: Walker & Co., 2010, f. 74, cituar në Gjon Boriçi, "Dorëheqja e detyruar e Enver Hoxhës si kryeministër i RPSH-së dhe

Kjo shifër ishte tri herë më e madhe nga ajo që kishte kërkuar Shqipëria me letrën e Mehmet Shehut të 22 janarit 1965. Në letrën falënderuese që Mehmet Shehu i dërgoi Çu En Lait, më 10 korrik 1965, i shprehu mirënjohjen e thellë për këtë ndihmë të re internacionaliste që Republika Popullore e Kinës i jepte Shqipërisë. Me anë të kësaj ndihme, në Shqipëri do të ndërtoheshin plotësisht veprat industriale të kërkuara, do të dërgoheshin pajisjet dhe materialet e ndryshme si dhe do të jepej ndihma teknike e nevojshme.¹²⁶

Si do të përdorej kredia kineze në Shqipëri?

Kredia kineze e vitit 1965 do të ndahej si më poshtë: 37.5% e zinte industria; 13.8% bujqësia; 11.3% komunikacioni; 18% shoqërore-kulturore dhe të tjerat 19%.¹²⁷ Por, më poshtë Spiro Koleka sqaron se me vendim të qeverisë veprat industriale do të zinin 51% të shumës së kredisë.¹²⁸ Megjithëkëtë "lumë parash" që po vërshonte nga Kina, përsëri Shqipëria do të vijonte të ishte vendi më i varfër i Evropës. Vetëm montimi i këtyre veprave do t'i kushtonte Shqipërisë 6 miliard e 500 milion lekë ose 52.8% e krejt vëllimit të tyre.¹²⁹

Sipas përlllogaritjeve të qeverisë shqiptare, veprat që do të përfundonin në pesëvjeçarin e katërt 1966-1970 me këtë kredi nga Kina do të ishin 12.¹³⁰ Veprat kryesore që do të viheshin plotësisht në prodhim do të ishin: në vitin 1966 mbaronte plotësisht uzina e superfosfatit në Laç, fabrika e çimentos në Fushë-Krujë, vepra nr. 6333-0 dhe vepra nr. 6333-D; mbaronte në vitin 1967 uzina e plehrave azotike, uzina e sodës, fabrika e çimentos në Elbasan, kombinati i tekstileve "Mao Ce Dun" (faza e dytë, fabrika e tullave në Fier dhe nr. 6333 A+B); në vitin 1968 mbaronte fabrika e xhamit dhe në vitin 1970 kombinati i metalurgjisë së zezë, reparti i shkrirjes.¹³¹ Vëllimi i ndërtimeve për këto vepra

kredia e parë kineze akorduar Shqipërisë, 1954", në *Studime historike*, nr. 3-4, 2019, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2020, f. 217-240.

¹²⁶ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1965, D. 1011, f. 50. Letra e Mehmet Shehut dërguar Çu En Lait.

¹²⁷ *Po aty*, fl. 18.

¹²⁸ *Po aty*.

¹²⁹ *Po aty*, fl. 19.

¹³⁰ *Po aty*.

¹³¹ *Po aty*, fl. 19-20.

parashikohej të ishte në 3 miliard e 300 milion lekë në vitin 1966; 1 miliard e 750 milion lekë në vitin 1967; 400 milion lekë në vitin 1968; 250 milion lekë në vitin 1969 dhe 300 milion lekë në vitin 1970. Gjithsej për këto vepra me rendiment të ulët, Shqipëria do të duhej të paguante 6 miliard lekë.¹³² Me ndihmën e kredisë kineze vetëm gjatë pesëvjeçarit të katërt 1966-1970 vëllimi i ndërtimeve industriale do të kapte shifrën marramendëse për ekonominë shqiptare të 15 miliard lekëve.¹³³ Çdo vit Shqipëria vetëm për ndërtime industriale do të paguante 3 miliard lekë.¹³⁴

Vendi nga pesëvjeçari i parë deri tek i katërti i kalonte shpenzimet e kapacitetit të tij duke u zhytur thellë e më thellë në borxhe. Në pesëvjeçarin e parë, Shqipëria kishte shpenzuar ndihma dhe kredi nga vendet socialiste të demokracive popullore 14 miliard lekë; në pesëvjeçarin e dytë 22 miliard lekë ose 57% më shumë; në pesëvjeçarin e tretë 37 miliard lekë ose 65% më shumë së në të dytin; në pesëvjeçarin e katërt 45 miliard lekë ose 24% më shumë së në të tretin.¹³⁵ Peshat specifike e krejt ndërtimeve industriale ishte marramendëse: 40.4% në pesëvjeçarin e parë, 30.9% në të dytin; 35% në të tretin dhe parashikohej 32% vetëm në fazën e parë në të katërtin.¹³⁶ Deri në fund të pesëvjeçarit të katërt, plani i ndërtimeve industriale do të kapte shifrën e 77% të krejt ndërtimeve.¹³⁷

Spiro Koleka vlerësonte se këto shpenzime të mëdha do t'i jepnin fryte ekonomisë shqiptare deri në 21 miliard e 800 milion lekë.¹³⁸ Nëse do të ndodhte kjo, Shqipëria do të ecte me këmbët e veta në vitin 1970 siç kishte parashikuar Enver Hoxha (që në fakt kishte qenë parashikim i ekspertëve sovjetikë në vitin 1957) dhe s'do të kishte më nevojë të merrte kredi nga Kina. Por, pikërisht në fundin e viteve '60 dhe në vitin 1970, Shqipëria do të merrte nga Kina edhe ndihmat dhe kreditë më të mëdha që do ta rëndonin deri në sfilitje ekonominë e dobët shqiptare. Gjithashtu, deri në vitin 1968, qeveria shqiptare duhej të vinte plotësisht në punë

¹³² *Po aty*, fl. 20.

¹³³ *Po aty*, fl. 21.

¹³⁴ *Po aty*, fl. 22.

¹³⁵ *Po aty*, fl. 23.

¹³⁶ *Po aty*, fl. 24.

¹³⁷ *Po aty*.

¹³⁸ *Po aty*, fl. 25.

nëpërmjet tri etapave TEC e Fierit me kapacitet 25 mijë kw dhe deri në fund të vitit 1970 edhe TEC e ri në Korçë me kapacitet 6 mijë kw.¹³⁹ Ndërtimi i TEC-it të Fierit, sipas Kolekës do të plotësonte nevojat për energji elektrike të vendit deri në vitin 1970.¹⁴⁰ Më pas, Shqipëria do të kishte probleme. Për këtë arsye, brenda pesëvjeçarit të katërt do të ishte e nevojshme të fillonte ndërtimi i një hidrocentrali të fuqishëm, i cili do të mund të vihej në punë deri në vitin 1972.¹⁴¹ Ndërtimi i hidrocentraleve mbi lumin Drin, duke filluar me atë të Vaut të Dejës me fuqi 170 mijë kw, do të ndërtohej së bashku me vijën e tensionit të lartë 220 kv dhe nënstacionet përkatëse.¹⁴²

Një fakt interesant që na vjen nga hulumtimi i këtij dokumenti tepër sekret, është se për industrinë e minierave, ndërtimet e tyre [minierave] parashikoheshin të ndërtoheshin aty ku ishin edhe burgjet më famëkeqe, si ai i Spaçit. Në Spaç, me kredinë kineze të vitit 1965, do të vihej në shfrytëzim miniera për nxjerrjen e bakrit dhe e mineralit të piritit.¹⁴³ Ishte e qartë se për të vënë në punë një sasi kaq të madhe veprash industriale për një popullsi kaq të vogël siç ishte ajo e Shqipërisë, duhej një "ushtri" e tërë skllëvërish. Dhe shumica e këtyre skllëvërve vinin nga burgjet, sidomos ato politike.*

Hidrocentrali i Vaut të Dejës kishte ritëm të ulët vetëm për muajt maj-tetor kur prurjet e lumit Drin ishin të dobëta, por kjo do të kompensohej nga uzina metalurgjike, e cila nga viti 1970 do të kishte aftësi shkrirjeje 300 mijë ton mineral hekur-nikeli në vit dhe do të ekuilibronte valutën e lirë që do të shërbente për blerjen e energjisë elektrike.¹⁴⁴ Me këtë përfundim, dukej se qeveria shqiptare kishte parashikuar gjithçka, por vitet që do të vinin do të tregonin se

¹³⁹ *Po aty*, fl. 29.

¹⁴⁰ *Po aty*, fl. 50.

¹⁴¹ *Po aty*.

¹⁴² *Po aty*.

¹⁴³ *Po aty*, fl. 51.

* Për më shumë mbi këtë argument shih Kastriot Dervishi, *Internimi dhe burgimi komunist në Shqipëri*, Tiranë: Shtëpia Botuese 55, 2012; dhe *Sigurimi i Shtetit 1944-1991; Historia e policisë politike të regjimit komunist*, Tiranë: Shtëpia botuese "55", 2012.

¹⁴⁴ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1965, D. 1011, fl. 57.

keqlllogaritjet ekonomike të klasës sunduese në Shqipëri, për madhësi të rreme, do të shembeshin vetëm mbi kryet e popullit shqiptar.

Përfundime

Një vend si Shqipëria me popullsi kaq të vogël, marrja e kaq shumë borxheve për të investuar në ngritjen e një industrie të rëndë kaq shumë të panevojshme për vendin, do të sillte pasoja dramatike ekonomike dhe për jetën e shqiptarëve. Është e vërtetë se me këto ndihma dhe kredi të mëdha nga ana e Republikës Popullore të Kinës, vendi deri diku kishte një pavarësi politike dhe pushtet të pasfidueshëm të Enver Hoxhës, por nga ana tjetër, në të ardhmen afatmesme do të shkaktonte krizë të rëndë ekonomike. Jo pak nga veprat që u ndërtuan me ndihmat dhe kreditë kineze për këto vite, shërbyen edhe për të shlyer kreditë e mëdha që kishte marrë vendi gjatë viteve '50 dhe në dy vitet e para të viteve '60 nga Bashkimi Sovjetik dhe nga vendet e tjera të demokracive popullore të cilat i kemi trajtuar gjerësisht në artikullin e mëparshëm.¹⁴⁵ Veprat e mëdha që u ndërtuan në këtë hark kohor me ndihmat dhe kreditë kineze do të pësonin një fat tragjik në periudhën pas ndryshimit të sistemit. Ndoshta, janë këto borxhe të stërmëdha të trashëguara nga sistemi i kaluar, ndërthurur edhe me mentalitetin e gabuar, që po bëjnë të mundur tejzgjatjen jashtë normales të tranzicionit politik shqiptar në epokën e pas Luftës së Ftohtë dhe në atë globale.

S u m m a r y

THE FIRST BIG WORKS BUILD IN ALBANIA WITH CHINESE CREDITS 1963-1965

In this paper I've tried to present to the professional reader some of the lately discovered facts that I have found during my research time in the

¹⁴⁵ Shih Gjon Boriçi, "Varësia e mbijetesës ekonomike të Shqipërisë nga ndihmat dhe kreditë e kampit socialist dhe të Republikës Popullore të Kinës 1956-1962", në *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2020, f. 213-234.

archives. Most of the facts I'm presenting in this paper are given for the first time. In two years (1963-1965) of special relationship between People's Republic of Albania with the People's Republic of China, Albania received from China huge amounts of loans, majority of which have been used to build a useless heavy industry, totally unacceptable for a small and poor country. In this period of time, especially after the visit of the Chinese premier Zhou Enlai at the end of December 1963, Albania was granted all the requests she presented for loans in Beijing. A lot of factories and mills were build and a whole army of Albanian "slaves" especially of political prisoners, worked to construct them. All the factories and plants that were going to be constructed in Albania with the Chinese loans, only for this period of time, would cost more than 21 billion lek (Albanian currency) equal to nearly 3 billion dollars, that was an impossible amount to be carried by the Albanian people. The time has proved that the investment of more than 50% of the Chinese loan in the heavy industry would have devastating impact on the economy of the country.